




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nh. 08 prot
DA 05/04/2024



VENDIM

Nr.5, datë 03/04/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR AUTORIZIM “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME BLEKTORALE KUR SHOQËROHET ME INSTALIME TUBACIONESH DHE NDËRTIME OBJEKTESH”, SUBJEKTIT “SILVA GJONDREKAJ”.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për autorizim “Për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blektorale kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh”, subjektit “Silva Gjondrekaj”, me vendndodhje: Fshati Plepan, Njësia Administrative Bërdicë, Bashkia Shkodoër, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e shpimit

- X=458527
- Y=4647792
- Z=12 m.m.n.d

Prurja e kërkuar: Q=0.7 l/s

Pika e shkarkimit

- X=458417
- Y=4647823
- Z=12 m.m.n.d

Prurja që shkarkohet: $Q=0.01$ l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

